

SONILA BOÇI

ZGJEDHJET E 2 DHJETORIT 1945

(Ngjarje që solli në pushtet apo legjitimoi pushtetin e komunistëve)

Rruga e komunistëve shqiptarë drejt marrjes së pushtetit

Shqipëria i përket grupit të vendeve ballkanike, në të cilat komunistët ndoqën rrugën e shpejtë për të ardhur në pushtet¹. Kjo do të thotë se komunistët shqiptarë, ashtu si ata jugosllavë, projektuan dhe zbatuan platformën e ardhjes së tyre në pushtet që gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në rezolucionin e mbledhjes themeluese të PKSh, në 8 nëntor 1941, komunistët shqiptarë kishin parashikuar si plan të tyre afatgjatë “qeverinë popullore demokratike”². Duke ndjekur urdhrat e KOMINTERN-it, për krijimin e Frontit Popullor, komunistët shqiptarë organizuan në 16 shtator 1942, Konferencën e Pezës. Sigurimi i dominimit të komunistëve në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar dhe në Këshillat Nacionalçlirimtarë të Krahinave, ishte hapi që u siguroi mbështetjen në popull dhe kredencialet para Aleatëve, si forca kryesore e rezistencës.

Ndryshimi i situatës ndërkombëtare, të krijuar pas kapitullimit të Italisë në shtator 1943, i dha shansin komunistëve shqiptarë, ashtu si atyre grekë dhe jugosllavë, të hidhnin vështrimin nga pushteti. Lufta civile që pasoi Konferencën e Labintit dhe denoncimin e Mbledhjes së Mukjes, përfundoi me eliminimin politik të organizatës kundërshtarë të Ballit Kombëtar.

¹ Bernard Lory, *Evropa Ballkanike, nga 1945 në ditët tona*, “Dituria”, Tiranë, 2007, f.36.

² *Dokumenta kryesore të PKSh*, vëll.I, “8 Nëntori”, Tiranë, 1971, f. 26.

Pas kësaj, udhëheqësit komunistë shqiptarë ecën drejt pushtetit. Në Kongresin e Përmetit, të mbajtur në 24 maj 1944, u vendosën, ndër të tjera, krijimi një Komiteti të Përgjithshëm që do luante rolin e një qeverie provizore; mosnjohja e asnjë qeverie shqiptare në mërgim; ndalimi i kthimit të mbretit Zog në Shqipëri etj. Këto vendime i dhanë mundësi komunistëve të krijonin të vetëm qeverinë provizore. Në 25 qershor 1944, me urdhër të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe në vazhdim të luftës civile, forcat partizane të rezistencës, kaluan Shkumbinin³. Në përfundim të këtij operacioni, forcat e ushtrisë partizane hynë me forcë në zonat e mbështetësve të mbretit Zog, duke i detyruar krerët e “Legalitetit” të linin vendin. Gjithashtu, ata arritën të godasin dhe krerë të tjerë të Veriut, si: vëllezërit Kryeziu, apo Muharrem Bajraktari, të cilët ishin të njohur për rezistencën e tyre kundër pushtuesve.

Qeveria Provizore Shqiptare e krijuar 23 tetor 1944 nga Mbledhja e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në Berat, përbëhej vetëm nga anëtarë të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Krijimi i qeverisë provizore ishte etapa e fundit e marrjes së pushtetit nga PKSH. Por, një qeveri që të jetë legjitime duhet të plotësojë dy parakushte: të tregojë se është përfaqësuese e ligjshme e qytetarëve të saj, e ardhur në pushtet me anë të zgjedhjeve të lira dhe demokratike, si dhe të sigurojë njohjen ndërkombëtare. Qeveria Provizore e dalë nga mbledhja e dytë e KANÇ-it në Berat nuk kishte plotësuar asnjërin nga të dyja.

Jalta: detyrimi për zgjedhje të lira

Në shkurt 1945, në takimin e Jaltës, ndër të tjera u vendos për rivendosjen e paqes dhe luftën kundër mbeturinave të nazifashizmit. Eliminimi i mbeturinave të nazi-fashizmit u vendos të realizohej me “vendosjen e qeverive provizore, në të cilat të përfaqësohen gjithë elementët demokratë të popullsisë që ndërmjet zgjedhjeve të lira duhet sa më shpejt të formojnë qeveri që i përgjigjen vullnetit të popullit”⁴.

Komunistët shqiptarë e kishin krijuar tashmë një qeveri provizore. Por, në ndryshim nga ajo që parashikonte marrëveshja e Jaltës dhe

³ Për më tepër mbi ashpërsinë e sjelljes së Ushtrisë Nacionalçlirimtare ndaj zonave veriore që mbështesnin legalistët dhe krerët lokalë si: Mat, Krujë, Dibër etj. shih: J. Amery, *Bijtë e Shqipërisë*, “Lumo Skëndo”, Tiranë, 2002, f. 246-249; si dhe: Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri 1943-1945*, “Drier”, Tiranë, 2006, f. 379-381.

⁴ Artur Conte, *Jalta dhe ndarja e Botës*, “Albinform”, Tiranë, 1994, f. 189.

ndryshe nga çfarë ndodhi në shtetet e tjera të lindjes, ku u krijuan qeveri koalicioni, në Shqipëri qeveria provizore përbëhej vetëm nga anëtarë të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili zotërohej tërësisht nga PKSH. Kishte disa arsye për mungesën e qeverisë së koalicionit: *Së pari*, Aleatët nuk kishin njohur ndonjë qeveri shqiptare në mërgim, ndërkohë lufta civile kishte eliminuar organizatat e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, nën pretekstin e bashkëpunëtorëve të pushtuesit. Një pjesë e krerëve të tyre kishin marrë rrugën e mërgimit, pjesa tjetër ishte arrestuar në pritje të daljes në “gjyqet e popullit”, të tjerë kishin marrë arratinë maleve me shpresën e organizmit të një rezistence të organizuar kundër qeverisë së Frontit. *Së dyti*, Shqipëria, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, nuk kishte pasur traditë të fuqishme parlamentarizmi shumëpartiak. *Së treti*, shkalla e zhvillimit ekonomik dhe strukturës shoqërore të vendit nuk kishte favorizuar krijimin e partive të majta, si: socialdemokrate apo fshatare, me të cilat komunistët shqiptarë të mund të bashkëpunonin, si ndodhi me partitë komuniste në vendet e Evropës Lindore.

Qeverisë shqiptare i duhej të plotësonte patjetër kushtin e fundit të vendimeve të Jaltës, pra zhvillimin e zgjedhjeve. Vetëm kështu mund të siguronte mbështetjen e duhur nga Aleatët, jo vetëm për pushtetin e komunistëve, por dhe vetë ekzistencën e shtetit shqiptar. Situata ndërkombëtare e shtetit shqiptar dhe e qeverisë shqiptare gjatë vitit 1945 mund të konsiderohej e rrezikshme. Qeveria shqiptare nuk u ftua të merrte pjesë në Konferencën e San Franciskos, mbledhjen themeluese të OKB, dhe rrjedhimisht nuk u pranua as në këtë organizatë. Qeverinë provizore shqiptare nuk e kishte njohur asnjë qeveri, përveç asaj jugosllave. Greqia vazhdonte të ushtronte trysni ndaj qeverive të Aleatëve Perëndimorë dhe OKB-së, për njohjen e pretendimeve greke në Shqipërinë e Jugut. Qeveria greke i kishte shtuar retorikës së saj mbi “strukturën etnike greke të Epirit të Veriut” edhe elementët strategjikë, si dhe persekutimin e minoritetit grek në Shqipëri nga qeveria komuniste e Enver Hoxhës. Situata e rënduar ndërkombëtare shtronte si domosdoshmëri për qeverinë provizore shqiptare, sigurimin e mbështetjes nga të gjithë Aleatët e Mëdhenj.

Në pranverë të vitit 1945, në Shqipëri arritën Misionet civile dhe ushtarake të Aleatëve. Qëllimi i tyre ishte raportimi mbi situatën në Shqipëri, në mënyrë që të përgatitej njohja e qeverisë shqiptare nga shtetet përkatëse. Në përfundim të këtij procesi ato paraqitën mendimet për hapat e mëtejshme në lidhje me njohjen e qeverisë provizore

shqiptare. Mbështetur në raportet e dërguara nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve kuptojmë se aleatët perëndimorë e kishin të qartë politikën pro Moskës të qeverisë së Enver Hoxhës, por ata ishin para faktit se qeveria provizore ishte e vetmja administratë e organizuar në vend. Në raportin e kryetarit të misionit civil amerikan, Xheikobs për Departamentin amerikan të Shtetit njoftonte se “regjimi i Enver Hoxhës gëzon mbështetje popullore më të gjerë se çdo grup tjetër në vend, se opozita ishte e çorganizuar dhe nuk kishte tjetër program veç antikomunizmit”.⁵ Të njëjtën gjë i njoftonte qeverisë britanike më 3 shtator 1945, kolonel Warner, kryetari i Ndërlidhjes Ushtarake Britanike në Tiranë⁶. Mendimi i Aleatëve Perëndimorë ishte i dyzuar për njohjen e menjëhershme të qeverisë provizore shqiptare. Sipas Ministrisë së Jashtme britanike, njohja e menjëhershme e qeverisë shqiptare, do të ishte një mënyrë për të “forcuar pozitën e brendshme të saj”⁷.

Për këto arsye, mendimi i Ministrisë së Jashtme britanike ishte “nëse ne mendojmë ta njohim (qeverinë shqiptare S.B.), mendoj se duhet t’i imponojmë disa kushte për të cilat duhet të biem dakord që më parë me qeverinë e SHBA. Ne duhet, të paktën të insistojmë në zgjedhjet e lira, për sa kjo mund të vlejë dhe mund të sigurojmë gjithashtu, premtimin për një amnisti të gjerë”⁸. Por aleatët britanike dhe amerikanë nuk ishin plotësisht në një mendje për sa i përket njohjes së qeverisë shqiptare⁹.

⁵ Hamit Kaba, *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë* (studime dhe dokumente), “Botimpeks”, Tiranë, 2007, f. 139

⁶ Foreign Office (më tej: FO) 371/48083/63818/R 14916, Warner vinte në dukje se Britania e Madhe duhet ta njihte regjimin e FNÇI, pasi nuk shihej ndonjë alternativë tjetër [ndaj këtij regjimi].

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Përfaqësuesi i Misionit Civil Amerikan, Jacobs, në ndryshim nga kolegu i tij britanik, mendonte se kishte disa arsye që i detyronin Aleatët ta njohnin qeverinë shqiptare. Së pari, paralelet që hiqeshin ndërmjet qeverive të kontrolluara nga komunistët në Rumani e Bullgari dhe asaj shqiptare nuk ishin të sakta. Sipas Jacobs, komunistët shqiptarë, ndryshe nga ata bullgarë dhe rumunë, kishin ardhur në pushtet me forcat e tyre dhe jo me imponimin sovjetik. Së dyti, ishin Aleatët që me anë të ndihmave të ofruara gjatë Luftës, e kishin lehtësuar ardhjen e komunistëve shqiptarë në pushtet. Së treti, “nga çdo qeveri në Shqipëri, do të ishte e kotë të prisje për të vëzhguar principe demokratike, ashtu siç kuptohen ato në Evropën Perëndimore. Vendi ishte shumë më i prapambetur edhe në krahasim me

Aleatët Perëndimore i shqetësonte fakti se qeveria sovjetike mund ta njihte në mënyrë të njëanshme qeverinë provizore shqiptare. Duke dashur të mbështesnin elementët pro-perëndimorë brenda Frontit, me shpresën për të parandaluar Shqipërinë të vihej plotësisht në kontrollin sovjetik, Aleatët perëndimorë rikonsideruan çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare. Në 4 tetor 1945, në një takim ndërmjet përfaqësuesve britanikë dhe amerikanë u ridiskutua çështja e njohjes së qeverisë shqiptare. Mendimi i përbashkët ishte t'i ofronin njohje të menjëhershme qeverisë provizore shqiptare, si masë parandaluese ndaj vartësinë totale të saj prej Jugosllavisë¹⁰, por duke u mbështetur në Deklaratën e Jaltës për Evropën e Çliruar¹¹.

Në 10 nëntor 1945, ashtu siç druheshin Aleatët Perëndimorë, qeveria e BRSS njohu zyrtarisht qeverinë shqiptare. Në të njëjtën ditë, qeveritë e Britanisë së Madhe dhe SHBA bënë një deklaratë për njohjen provizore të saj. Ato njoftuan se njohja zyrtare do të realizohej pas plotësimit të disa kushteve: zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike, si dhe pranimi i gazetarëve perëndimorë gjatë fushatës dhe ditës së zgjedhjeve¹².

E ndodhur para kësaj trysnie, qeverisë provizore shqiptare nuk i mbetej, veçse të merrte të gjitha masat e nevojshme që të zhvillonte zgjedhjet, të siguronte fitoren në to, duke ruajtur imazhin e zgjedhjeve të lira e demokratike.

Qeveria Provizore në prag të zgjedhjeve: propaganda, dhuna dhe korniza ligjore

Që gjatë Luftës, komunistët kishin premtuar se në përfundim të saj, populli shqiptar do të ishte i lirë të shprehej për formën e regjimit të shtetit të tij. Në proklammatën e Qeverisë Provizore të formuar në Berat,

Bullgarinë dhe Rumaninë, dhe ne nuk duhet të jemi kaq këmbëngulës për të vëzhguar principet demokratike”.

¹⁰ *United State National Archive* (më tej: *USNA*), 875.01/10-1645. Raport i James Clement Dunn për Departamentin e Shtetit: procesverbali i bisedimeve ndërmjet përfaqësuesve britanikë dhe atyre amerikanë mbi çështjen e njohjes së Shqipërisë, datë 16 tetor 1945.

¹¹ *Po aty*.

¹² *USNA*, 875.01/11-801. Telegram nr. 99 dërguar nga Foreign Office për Departamentin e Shtetit të SHBA, me tekstin e njohjes së administratës shqiptare si qeveri provizore, 9 nëntor 1945.

ndër të tjera premtonte se: “pas çlirimit të vendit dhe pasi të ketë stabilizuar gjendjen do të procedojë me bërjen e zgjedhjeve të lira, në mënyrë demokratike për Asamblenë Kushtetuese¹³”.

Udhëheqësit e PKSh e kishin të qartë rëndësinë e zhvillimit të zgjedhjeve, por më shumë se këtë ata kishin të qartë rëndësinë e fitores në këto zgjedhje. Ato do t’i shërbenin si pasaportë jo vetëm për të legalizuar pushtetin e tyre, por dhe për të qenë të lirë për të ndërmarre në të ardhmen të gjitha masat për të vendosur dhe konsoliduar regjimin komunist. Në harkun kohor nga dhjetori 1944 deri në 2 dhjetor 1945, PKSh i vuri vetes disa detyra, të cilat do ta ndihmonin në arritjen e fitores në zgjedhje.

Detyra e parë ishte marrja e masave për forcimin e pozitave të qeverisë. Politika e ndjekur nga udhëheqësit e PKSh ishte shumë e kujdesshme. Ata u përpoqën të përdornin dhe gurin dhe arrën. Nga njëra anë morën masa të shpejta për të kaluar vështirësitë e shumta të një vendi të sapodalë nga lufta. Qëllimi ishte të fitonin besimin e shtresave më të varfra të popullsisë dhe për t’i treguar atij “se ky është pushteti i tij¹⁴”. U zhvillua një punë e madhe për të ndërtuar objektet publike të shkatërruara nga lufta. U krijuan komisionet e asistencës sociale, të cilat do të ndihmonin familjet e dëmtuara nga lufta. Nga ana tjetër, duke qenë se ndihma do të jepej nga popullsia dhe jo nga shteti, komisionet duhet të zhvillonin propagandë që të rrisnin shkallën e solidaritetit midis popullsisë¹⁵. Porosia e vazhdueshme e KQ të PKSh ishte se çdo punë e këtyre komisioneve duhej të shoqërohej me propagandë në popull. Në vazhden e masave për të rritur besimin e popullit ndaj qeverisë provizore ishte dhe fushata për uljen e disa taksave. Veçanërisht rëndësi iu dha në shtypin e kontrolluar nga PKSh, propagandimit të Reformës Agrare¹⁶. Zbatimi i saj ishte një premtim i bërë shqiptarëve që pas shpalljes së pavarësisë, por që nuk kishte arritur asnjëherë të vihej në jetë. Zbatimi i

¹³ *Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar (1942-1944)*, botim i Institutit të Historisë së Partisë, pranë KQ të PPSH, Tiranë, 1962, f. 294.

¹⁴ Në të gjithë korrespondencën e drejtuesve të PKSH me komunistët e bazës, gjatë vitit 1944-1945, përsëritet vazhdimisht shprehja: “ne duhet t’i tregojmë popullit se ky është pushteti i tij”.

¹⁵ *Dokumenta kryesore ...*, f. 295.

¹⁶ Bernd J. Fisher, *Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945*, “Çabej”, Tiranë, 2004, f. 328.

saj, pavarësisht mangësive të shumta që ajo shfaqti që në fillimet e saj, apo interesave afatgjata të komunistëve, i shërbeu rritjes së numrit të mbështetësve të Frontit.

Nga ana tjetër duhet të eliminonin të gjithë ata, të cilët ishin pengesë për planet e tashme dhe të ardhme të komunistëve, pra kundërshtarët politikë. Këta mund t'i ndajmë në disa kategori. Një pjesë ishin anëtarë të çetave të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, të cilët kishin mbetur në vend dhe vazhdonin qëndresën kundër komunizmit me luftë të armatosur. Kategoria tjetër e kundërshtarëve të komunistëve përbëhej nga një pjesë e madhe e shtresave të mesme dhe të pasura të shoqërisë. Ata ishin kundër ndryshimeve sociale dhe politike të premtuara dhe të propaganduara nga komunistët, pasi në to shihnin shkatërrimin e pronës private dhe sipërmarrjes së lirë. Kundërshtarë të komunizmit ishin dhe një pjesë e mirë e intelektualëve, të cilët ishin shkolluar jashtë dhe kërkonin instalimin e një demokracie liberale në Shqipëri. Shumë skeptikë për PKSh dhe komunizmin ishin krerët dhe popullsia e Shqipërisë së Veriut. Ata duke qenë "konservatorë, të lidhur fort pas tokës dhe të përkushtuar ndaj zakoneve tradicionale dhe dokeve, përfshirë dhe fenë¹⁷ shihnin te komunizmi, rrezikun e ndryshimit të mënyrës së tyre të jetesës. Nga një analizë e tillë mund të nxjerrim si përfundim se komunistët qëndronin me këmbët në rërë. Baza mbështetëse e tyre në shoqërinë shqiptare nuk ishte dhe aq solide.

Në mbledhjen e Beratit, Enver Hoxha kishte deklaruar se "do të ndiqeshin të gjithë ata që merren me veprimtari fashiste apo profashiste"¹⁸. Por në konceptin e udhëheqësve të PKSh në grupin e fashistëve dhe profashistëve ishin të gjithë ata që kundërshtonin reformat e ndërmarra nga qeveria provizore¹⁹.

Politika e udhëheqësve të PKSh nuk ishte e njëjtë ndaj të gjithë kundërshtarëve politikë. Ata u treguan mjaft të ashpër ndaj një pjese, në mënyrë që të frikësonin tjetrën. Ndaj atyre që konsideroheshin kundërshtarët më të hapur të PKSh: çetat e mbetura të Ballit Kombëtar, apo mbështetësit e mbretit Zog, në vazhdimësi u zhvillua një luftë të ashpër e drejtpërdrejtë dhe propagandistike. Brigada të Ushtrisë Nacionalçlirimtare u përfshinë në ndjekjen e këtyre çetave. Luftime të

¹⁷ Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar*, "IKK&Princi", Tiranë, 2007, f. 28.

¹⁸ Enver Hoxha, *Veprat*, vëll. 2, "8 Nëntori", Tiranë, 1971, f. 375.

¹⁹ *Po aty*.

ashpra u zhvilluan në gjithë Shqipërinë. Përfundimi i luftimeve solli si pasojë jo vetëm humbjen në masë të madhe të çetave kundërshtarë, por u shoqëruan me vrasje, arrestime dhe jo rrallë ekzekutime pa gjyq²⁰.

Një mënyrë tjetër për eliminimin dhe frikësimin e kundërshtarëve politikë ishin dhe gjyqet e Kriminelëve të Luftës²¹. Në 6 dhjetorit 1944 u miratua ligji për zbulimin dhe dënimin e kriminelëve të luftës. Në 28 dhjetor 1944, KQ i PKSHE udhëzoi të gjitha komitetet qarkore të PKSHE të qarqeve për krijimin e Komisioneve për zbulimin e tyre. Arsyeja e krijimit të tij ishte mungesa e statistikave të sakta për ata që konsideroheshin kriminelë luftime²². Po në të njëjtin muaj filloi arrestimet e “kriminelëve të luftës”. Në mars 1945 u hap në sallën e Kinema “Kosova” në Tiranë, procesi i gjyqit special kundër kriminelëve të luftës. Nga 60 të pandehurit e këtij gjyqi, 19 vetë u dënuan me vdekje. Vendimi u zbatua për 17 prej tyre, ndërsa të tjerët morën dënime të rënda²³. Gjyqi special ishte i pari në një seri të gjatë gjyqesh ndaj “kriminelëve të luftës”. Trupi gjyqësor i Gjykatës Speciale, kryesohej nga Ministri i Brendshëm, Koçi Xoxe dhe në përgjithësi përbëhej nga njerëz jokompetentë, të cilët ishte e qartë se jepnin dënime politike.

Detyra e dytë, e lidhur ngushtë me të parën, kishte të bënte me forcimin dhe riformatimin e vetë Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Fronti ishte një organizatë e gjerë, që përfshinte pjesën më të madhe të atyre që donin të luftonin për çlirimin e vendit. Por pas çlirimit, PKSh që kishte arritur të merrte në dorë drejtimin e tij, e përdori Frontin dhe për detyra të tjera. PKSh, ashtu si gjatë luftës, vazhdonte të qëndronte në legalitet. Pjesa më e madhe e popullsisë, as e njëjthe dhe as e kuptonte se çfarë ofronte komunizmi dhe PKSh. Duke qëndruar e fshehur brenda

²⁰ Për një panoramë të plotë të luftimeve të brigadave të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër çetave kundërshtarë të komunistëve shih: Demir Dymishi, *Vepërtaria e bandave dhe e organizatave opozitare ilegale në Shqipëri (1944-1948)*, “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2003, fq. 31-86.

²¹ Evidentimi, arrestimi dhe dënimi i kriminelëve të luftës ishte pjesë e procesit të denazistikimit të Evropës së pas Luftës së Dytë Botërore. Por, komunistët shqiptarë e përdorën këtë proces si mjet për të eliminuar edhe kundërshtarët politikë, krahas bashkëpunëtorëve të vërtetë të pushtetit dhe kriminelëve të luftës.

²² *Dokumenta kryesore ...*, f. 295.

²³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: AMPB), Fondi i proceseve gjyqësore, viti 1945, dos. 1568.

Frontit, PKSh, e kishte më të lehtë të plotësonte synimet e veta strategjike në një popullsi me nivel të ulët kulturor dhe politik. Sidomos, duke mbajtur statusin e ilegalitetit brenda Frontit, që konsiderohej organizata më gjithëpërfshirëse në vend, PKSh parandalonte ravijëzimin e partive të tjera si brenda, ashtu dhe jashtë tij.

Në prill 1945 u zhvillua fushata e zgjedhjeve për Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtarë. Ajo shërbeu për të krijuar bazat e pushtetit lokal të PKSh në të gjithë vendin. Rëndësi primare kishte spastrimi i këshillave të kohës së luftës nga elementë të dyshimtë për PKSh, si dhe të ngrinte Këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtarë në zonat që gjatë luftës nuk e kishin mbështetur Frontin Antifashistë Nacionalçlirimtar²⁴. Fushata për zgjedhjen e Këshillave Antifashistë Nacionalçlirimtarë u përball me kundërshtimin e hapur të popullsisë në zonën veriore të vendit. Njësitë partizane të Mbrojtjes së Popullit, të frikësuara nga ndonjë reagim i armatosur i kësaj popullsie, ndërmoren një fushatë të gjerë çarmatimi²⁵. Raportet e komiteteve qarkore të PKSh në veri të vendit dëshmojnë fare qartë dhunën e ushtruar në zona të ndryshme, si: Peshkopi, Malësinë e Shkodrës, Mirditë, Pukë, Mat për të detyruar banorët e tyre t'i bindeshin urdhrave dhe pushtetit të komunistëve²⁶. Por, pavarësisht se u arrit të ngriheshin bazat e pushtetit lokal të regjimit të ri, komunistët nuk mundën ta kontrollonin plotësisht popullsinë e Veriut.

Pasi vunë bazat e pushtetit lokal, udhëheqësit komunistë iu futën punës për ta organizuar Frontin e dikurshëm Nacionalçlirimtar, si një organizatë thjesht politike. Në korrik 1945 filloi fushata e përzgjedhjes së delegatëve për Kongresin e Frontit Antifashistë Nacionalçlirimtar. Në

²⁴ Janë interesante dëshmitë që na vijnë nga misionet e huaja të vendosura në Tiranë mbi zhvillimin e zgjedhjeve për këshillat Antifashistë Nacionalçlirimtarë. Zgjedhjet në qytetet kryesore të vendit u bënë nëpër mbledhjet e lagjeve, në të cilat përzgjidheshin vetëm mbështetësit e Frontit Antifashistë Nacionalçlirimtar. Votimet për anëtarët e këshillave bëheshin me votim të hapur, pra të gjithë pjesëmarrësit ngrinin grushtin lart. Nuk kishte raste kur të kishte propozim nga salla për ndonjë kandidat alternativ, apo të rrëzohej ndonjë kandidat i paraqitur.

²⁵ *Arkivi Qendror i Shtetit* (më tej: *AQSh*), F. 14/Arkivi i Partisë (më tej: *AP*) strukturat, viti 1945, dos. 2, fl.7.

²⁶ *Po aty*. Në dosje përfshihen relacione të komiteteve qarkore të PKSh nga zonat e Peshkopisë, Kukësit, Shkodrës etj., ku tregohet qartë për problemet që hasën drejtuesit komunistë në këto zona dhe reagimin e ashpër të tyre ndaj malësorëve.

qarkoren që KQ i PKSh i dërgonte komiteteve të PKSh, RKSh dhe divizioneve ushtarake në të gjithë vendin, porosiste komunistët t'i kushtonin rëndësi fushatës për zgjedhjen e delegatëve. "Kongresi i Frontit, - sipas qarkores, - duhet të dëshmonte unitetin politik të kombit në vijën e Frontit"²⁷. Qarkorja jepte udhëzime mbi delegatët e Frontit. "Të punoni në mënyrë të tillë, - porosisnin udhëheqësit e PKSh, - që një pjesë e mirë e delegatëve të jenë anëtarë të PKSh, më shumë se gjysma të jenë njerëz afër nesh, të tjerë të jenë elementë që duke u zgjedhur delegatë e duke punuar dhe ne me ta, të afrohen më shumë tek ne"²⁸. Ajo që ishte propaganduar si një fushatë e lirë në popull, zhvillohej nën kontrollin e rreptë të PKSh. Në dokumentacion të bie në sy fakti se vetë PKSh, porosiste në mënyrë të përsëritur dhe të prerë që e gjithë fushata duhet të zhvillohej në emër të Frontit.

Kongresi i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar filloi punimet në 3 gusht 1945. Ai kontrollohej në masë të madhe nga komunistët dhe përkrahësit e tyre. Në të kishte gjithashtu dhe antikomunistë, të cilët në pamundësi të organizoheshin në parti politike kishin vendosur të hynin në përbërje të Frontit. Pasi kishte siguruar pozitat e saj brenda Frontit, i cili tani quhej Fronti Demokratik, PKSh e kishte të hapur rrugën për të plotësuar detyrën e saj të tretë, hartimin e ligjeve zgjedhore, caktimin e datës së zgjedhjeve dhe çeljen e fushatës elektorale.

Nga 27-29 shtator 1945 u zhvillua mbledhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Për tre ditë rresht, mbledhja diskutoi dhe miratoi një paketë ligjesh, për zgjedhjet e pritshme. Paketa përbëhej nga Ligji për Asamblenë Kushtetuese, Ligji i Zgjedhjeve dhe Ligji për Listat Elektorale.

Ligji për Asamblenë Kushtetuese sanksiononte si detyra të saj: të vendoste për formën e regjimit, si dhe të miratonte statusin e shtetit shqiptar.

Ligji i zgjedhjeve jepte dispozita të plota për gjithë procesin e zhvillimit të zgjedhjeve. Ai parashikonte votim të përgjithshëm, universal dhe të drejtpërdrejtë. Kjo donte të thoshte që shmangej votimi me zgjedhës të dytë që ishte përdorur në zgjedhjet në Shqipëri në periudhën

²⁷ *Dokumenta kryesore ...*, f. 319.

²⁸ *Po aty*, f. 321.

midis dy luftërave. Për herë të parë u njihej e drejta e votimit dhe grave²⁹. Mirëpo, neni 4 i këtij ligji kishte një kontradiktë me parimin e votimeve të përgjithshme, pasi ai parashikonte se “në zgjedhje kanë të drejtë të votojnë nënshetetasit që gëzojnë këtë të drejtë sipas ligjit për listat elektorale”³⁰. Ligji, gjithashtu, njihte të drejtën e partive të tjera, si dhe kandidatët e pavarur për të paraqitur kandidatura në zgjedhje, nëse arrinin të mblidhnin 20 firma për kandidatët e pavarur dhe 70 për subjektet politike³¹. Pavarësisht nga kjo, ligji nuk parashikonte mënyrën e krijimit dhe të legalizimit të partive dhe organizatave politike që do të merrnin pjesë në zgjedhje. Mungesa e një ligji të veçantë për to e bënte të pamundur zbatimin e këtyre neneve në kushtet e Shqipërisë. Nga ana tjetër, ligji kishte disa të çara për të shmangur kandidaturat e papëlqyeshme për drejtuesit e PKSh. Komisionit të Zgjedhjeve i lihej një periudhë prej 48 orësh nga regjistrimi i kandidatëve për të bërë verifikimin nëse ata kishin të drejtë të zgjidheshin. Në përfundim të këtij afati, Komisioni mund të mos e pranonte kandidaturën nëse verifikonte se nënshkruesve mbështetës të tij u ishte mohuar e drejta e votimit. Një e metë tjetër e ligjit për zgjedhjet ishte mënyra e administrimit të procesit. Ai administrohej nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe komisionet e zgjedhjeve në qarqe e rrethe. Kryetari, sekretari dhe 5 anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve zgjidheshin nga kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Ndërsa për komisionet e qarqeve emërimin e bënte Komisioni Qendror i zgjedhjeve, me propozimin e Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës. Përgjegjësia për ruajtjen e qendrës së votimit, sipas ligjit, i ishte caktuar kryetarit i këshillit të Frontit të zonës. Pra, i gjithë procesi i administrimit të votës ishte në dorën e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar. Në ligj nuk parashikoheshin se si do të kontrolloheshin këta përfaqësues për kryerjen e detyrës së tyre. Në kushtet kur në këshillat e zonave ishin vendosur njerëzit e bindur të PKSh, procesi nuk mund të konsiderohej as transparent dhe as i ndershëm. Në ligj parashikohej dhe mënyra e votimit. Duke marrë

²⁹ Ligja nr. 124, datë 28 shtator 1945, *Mbi zgjedhjen e përfaqësuesave të popullit në Asamblenë Kushtetuese*, botuar në: “Gazeta zyrtare”, nr. 54, 1 tetor 1945.

³⁰ *Po aty*.

³¹ *Po aty*.

parasysh shkallën e lartë të analfabetizmit në vend, ligji i zgjedhjeve parashikonte votimin me gogla³².

Demokratët që gjendeshin në Këshillin e Frontit Demokratik e kuptuan se Ligji ishte larg standardeve të demokracisë perëndimore të kohës dhe, më e rëndësishmja, nuk ishte i zbatueshëm në situatën reale të vendit. Në diskutimin për miratimin e ligjit, Gjergj Kokoshi, anëtar i Këshillit Antifashist dhe Ministër i Arsimit, vuri në dukje faktin që ligji nuk i përmbahej parimeve demokratike dhe shpalli votën e tij kundër. Ai mendonte se koha e luftëtarëve kishte përfunduar me përfundimin e luftës. Tani ishte koha e njerëzve të aftë dhe të shkolluar, të cilët do ta zhvillonin vendin³³. Mirëpo, ligji i zgjedhjeve, nuk “u jepte shanse të barabarta atyre (njerëzve të shkolluar S.B.) që për shkak të bindjeve të tyre politike të mos duan të marrin pjesë në Front, por mund të jenë shumë të vlefshëm për të ardhmen e vendit”³⁴. Ai parashikonte se Fronti kishte shanse absolute për fitoren e zgjedhjeve, jo për mbështetjen që gëzonte në popull, por sepse: së pari, nuk u jepte kohë kandidatëve apo grupeve politike jashtë Frontit që të organizoheshin për të fituar dhe së dyti, zotëronte të gjitha mjetet e mundshme propagandistike. Shqetësimi më i madh i Gjergj Kokoshit ishte se, kandidatët jashtë Frontit, nuk do të konkurronin thjesht me një organizatë politike, por me një makinë qeverisëse shtetërore.

Ligji mbi zgjedhjet ishte gjithashtu larg filozofisë politike të PKSh. Parimet që ai shpaloste, nëse do të zbatoheshin, do të çonin drejt një modeli demokratik e shumëpartiak të qeverisjes. Kjo binte tërësisht ndesh me vizionin e PKSh, e cila i jepte një kuptim tjetër demokracisë. Për PKSh nuk do të thoshte një sistem shumëpartiak dhe zgjedhje me shumë

³² Votimi, sipas nenit 43 të ligjit mbi zgjedhjet e përfaqësuesve për Asamblenë Kushtetuese, bëhej në këtë mënyrë: “Kur votuesi merr kokrrën e votimit e ven në dorën e djathtë, ose në të mëngjert; në qoftë se nuk e ka të djathtë, mbyll grushtin dhe me grusht të mbyllur shkon në çdo kuti dhe me radhë e fut grushtin e mbyllur brenda. Kokrrën e lëshon në kutinë e asaj liste ose t’atij kandidati për të cilin don të japë votën e tij. Kur heq dorën nga kutija e fundit e hap në sy të gjithëve në mënyrë që ta shohin të gjithë se nuk ka gjë në dorë. Gjatë kohës që bëhet votimi, kryetari dhe anëtarët e këshillit shikojnë më kujdes që votuesi të mos e hedhë votën me dorën tjetër dhe të mos e marrë me vehte”

³³ Fjala e prof. Gjergj Kokoshit në Mbledhjen e KANÇ-it, në: “Bashkimi”, 28 shtator 1945.

³⁴ Po aty.

alternativa. Ajo nuk kishte aspak ndërmend të ndante pushtetin, apo të pranonte një regjim tjetër përveç atij që kishte planifikuar. Në propagandën e saj, PKSh mendohej t'u shpjegonte masave se kishte "dy lloj demokracish": në njërin toleroheshin të gjitha llojet e partive, madje dhe ato fashiste. Ndërsa, në demokracinë që ofronin komunistët "fashizmit i ndërtohej një barrierë e fuqishme ... Nëse ka njerëz të cilët e konsiderojnë këtë demokraci si diktaturë, ne i themi se një diktaturë që godet fort fashizmin dhe i jep të gjithë të drejtat dhe liritë popullit, është demokracia më e gjerë që ekziston në këto rrethana"³⁵. Për këtë arsye, KQ i PKSh porosiste komitetet e qarqeve që gjatë zhvillimit të fushatës së zgjedhjeve të mos popullarizonin parimet demokratike të ligjit, por "frymën e tij"³⁶, pra idenë se zgjedhjet do të zhvilloheshin të lira.

PKSh gjeti mekanizmat për të minimizuar efektet e ligjit për zgjedhjet, në fitoren e saj. Këtë e bëri nëpërmjet Ligjit mbi Listat Elektorale. Shumë nene të tij kundërshtonin në mënyrë të hapur parimet mbi të cilat bazohej ligji për zgjedhjet dhe veçanërisht parimin që vota ishte universale dhe e përgjithshme. Neni 4 i "Ligjit për Listat Elektorale" u hiqte të drejtën e votimit disa grupeve të qytetarëve shqiptarë. Përrjashtoheshin nga e drejta e votimit, ministrat dhe funksionarët shtetërorë të kohës së pushtimit, të arratisurit politikë, kriminelët e luftës dhe armiqtë e popullit³⁷. Mungesa e përcaktimeve dhe e kritereve të qarta në këtë ligj për çfarë do të kuptohej me secilën nga këto kategori, linte shteg për të përjashtuar nga procesi i votimit të gjithë kundërshtarët politikë. Karakteri përjashtues i nenit 4 theksohet dhe nga një raport i përfaqësuesit britanik në Tiranë ku thuhet: "janë shumë të paktë shqiptarët, të cilët në 20 vitet e fundit të mos kenë pasur të bëjnë me zogistët, italianët, Ballin Kombëtar, Legalitetin ose ligjin"³⁸. Në këtë mënyrë, komisionet e hartimit të listave mund të linin jashtë tyre këdo që e konsideronin kundërshtar.

Nga ana tjetër, në paragrafin II të nenit 4 të Ligjit për Listat Elektorale, parashikohej se përjashtoheshin nga votimi "kriminelët e luftës dhe armiqtë e popullit dhe çdo person tjetër i dënuar nga gjyqet

³⁵ Nga fjala e prof. Sejfulla Malëshovës, në: "Bashkimi", 27 shtator 1945.

³⁶ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 147, fl. 7.

³⁷ Ligja nr. 125, datë 29.9.1945, *Mbi listat elektorale*, botuar në: "Gazeta Zyrtare", nr. 54, 1 tetor 1945.

³⁸ FO 371/48085/63888. Raport i Misionit Britanik mbi zhvillimin e fushatës së zgjedhjeve në Shqipëri.

ushtarake ose speciale me burgim të përjetshëm, me humbjen e të drejtave qytetare dhe politike përgjithmonë ...”³⁹, pra personat ndaj të cilëve ishte marrë një vendim nga gjykata. Por u tejkalua dhe vetë ligji, u përjashtuan nga listat e votuesve të gjithë elementët e përfshirë në listat e kriminelëve të luftës, edhe ata ndaj të cilëve nuk ishte marrë ndonjë vendim gjykate për të vërtetuar fajësinë e tyre. Përfshirja në listat e votuesve e individëve të arratisur jashtë shtetit, të cilën ende ruanin statusin e qytetarit shqiptar, si dhe të arratisurit në male, ishte një kërkesë e vazhdueshme e misionëve të huaja në Shqipëri.

PKSH, në mënyrë që të shtonte numrin e votuesve pro regjimit që ajo kërkonte të instalonte, përfshiu në listat e kandidatëve për asamblistë, elementë me autoritet në zonat e tyre, por që nuk mbështesnin komunizmin. Kjo gjë ishte më e dukshme në zonën e Shkodrës, Kukësit dhe të Peshkopisë, ku opozita antikomuniste ishte më e fuqishme. Kështu, në zonën e Peshkopisë, sipas porosisë së KQ të PKSh, duhet të përfshihej në listat e kandidatëve, Selim Jegeni, një figurë me shumë influencë në popullsinë e zonës, por që nuk kishte pranuar të merrte pjesë as në lëvizjen çlirimtare të drejtuar nga komunistët, as në Këshillin e Qarkut, pra ishte antikomunist⁴⁰. Gjithashtu, u zhvillua një punë e madhe propagandistike për të bindur bajraktarët e krahinave dhe fshatarët e pasur, me influencë për të mbështetur kandidaturat e Frontit⁴¹.

Fushata e zgjedhjeve: Opozita e “munguar” dhe dominimi i PKSH

Sipas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, fushata duhet të fillonte në 7 nëntor 1945. Në të vërtetë ajo filloi që në 15 tetor 1945, me mitingjet që Komitetet e PKSh së qarqeve organizuan në të gjitha rrethet e vendit. Fillimi i fushatës vuri në lëvizje si PKSh, ashtu dhe opozitën antikomuniste. Në të vërtetë, ajo e paorganizuar, e dobët dhe e përçarë, ishte shpresa me e madhe për fitore e komunistëve. Krahas mungesës së traditave të pluralizmit partiak, në mungesën e organizimit të opozitës kishte ndikuar edhe politika e frikësimit të elementëve opozitare të ndjekur nga komunistët.

³⁹ Ligja nr. 125, datë 29.9.1945, *Mbi listat elektorale*, botuar në: “Gazeta zyrtare”, nr. 54, 1 tetor 1945.

⁴⁰ *AQSH*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 147, fl. 11.

⁴¹ *Po aty*, fl. 34.

Një pjesë e opozitës, megjithatë, kishte filluar të organizohej. Kështu, në prill 1945, në Shkodër ishte formuar “Bashkimi Shqiptar”. Kjo organizatë përbëhej kryesisht nga kleri katolik. Në vjeshtë 1945 u formua “Bashkimi Demokratik” nga bashkimi i Grupit Monarkist, Grupit të Rezistencës dhe Grupit Socialdemokrat. Në krye të këtij grupi ishte ish-anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, Gjergj Kokoshi, i cili kishte dhënë dorëheqjen nga kjo organizatë. Ligjërisht nuk ishte njohur asnjë grup apo parti opozitare. Qëndrimi i PKSH në lidhje me këtë çështje ishte mjaft i prerë: “Ne (PKSh), nuk do të lejojmë grupe opozitare⁴²”. Për udhëheqësit e PKSH, Fronti Demokratik ishte organizata politike e të gjithë popullit dhe vetëm ata që ishin fashistë dhe profashistë nuk dëshironin të përfshiheshin në të. Ky konceptim i individëve jashtë Frontit, në një kohë kur në botë po zhvillohej një fushatë për dënimin e kriminelëve të luftës, sigurisht që do të frenonte opozitën. Individët opozitarë nuk do të pranonin të dilnin si kandidatë të pavarur. Njëkohësisht, ishte e vështirë të siguroje 20 firmat e kërkuara nga ligji për kandidatët e pavarur, pasi edhe firmëtarët do të etiketoheshin si reaksionarë.

Opozita antikomuniste edhe në këto kushte, kur presioni i udhëheqësve të komunistëve ishte i ashpër u përpoq të reagoje. Ajo me anë të parullave që lëshoi gjatë fushatës kërkoi që kandidatët e PKSH të dilnin në një listë më vete⁴³. Qëllimi i tyre ishte që, brenda Frontit, të diferencoheshin nga kandidatët komunistë apo pro-komunistë. Kështu do të ishte më e lehtë të evidentoheshin mbështetja reale e komunistëve në popull. Nga ana tjetër, nëse PKSH dilte si parti e veçantë brenda Frontit, në listën kombëtare (proporcionale) do të kishte më shumë mundësi për t’u përfshirë kandidatët jo komunistë. Sigurisht, kjo kërkesë ishte fare e papranueshme për PKSh, për arsye që janë sqaruar më lart.

Nga fundi i nëntorit 1945, një pjesë e opozitës antikomuniste i paraqiti një peticion Misionit Ushtarak britanik dhe atij civil amerikan. Në të kërkohej: shtyrja e datës së zgjedhjeve; garanci për ruajtjen e jetës, nderit dhe lirisë së kandidatëve; shtyp të lirë dhe propagandë e barabartë për të gjithë kandidatët; vëzhgim të zgjedhjeve nga komisione të Aleatëve perëndimore⁴⁴. Ministria e Jashtme britanike u shpreh skeptike

⁴² *Po aty*, Fondi 14/AP org. udh., viti 1945, dos. 1, fl. 12.

⁴³ *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 147, fl. 22.

⁴⁴ FO 371/48085/63888/ R 19859/46/90

ndaj grupit që i kishte paraqitur peticionin. Asnjë nga nënshkruesit e tij nuk konsideroheshin si njerëz me influencë nga Misioni Britanik. Një pjesë e tyre kishin mbajtur poste të parëndësishme në të kaluarën. Ndër nënshkruesit e peticionit, mungonin anëtarët më në zë të opozitës shqiptare, binte në sy veçanërisht mungesa e emrit të Gjergj Kokoshit. Brigadier Hoxhsonit, shefi i Misionit Ushtarak Britanik, kishte shfaqur mendimin se “megjithëse në vend ka një opozitë të konsiderueshme ndaj regjimit të tanishëm (qeverisë provizore S.B.), ajo është fare e paaftë të organizohet në një forcë politike efektive dhe nuk është e aftë të zëvendësojë qeverinë e tanishme me një administratë adekuate⁴⁵”.

Në 28 nëntor 1945, në ditën e Festës Kombëtare një grup i opozitës lëshoi një thirrje për popullin shqiptar në emër të Bashkimit Demokratik. Me anë të saj opozita përpiqej t’i tregonte popullit shqiptar se Fronti Demokratik në të vërtetë ishte Partia Komuniste. Në mënyrë të qartë proklamohej se lloji i regjimit që ajo kërkonte të instalonte në Shqipëri, nuk do të ishte aspak demokratik. Thirrja tërhoqte vëmendjen se qeverisja e deriatëhershme e Frontit Demokratik i kishte sjellë popullit shqiptar “zhdukjen misterioze të mijëra njerëzve të pafajshëm, burgjet e tmerrshme dhe torturat çnjerëzore, që ndodhin në të gjithë vendin me anë të “Gjykatave të Popullit”, kupto të PKSH, e cila detyron “Qeverinë e Popullit” të mos e lejojë popullin tonë të shprehë dhe të mbrojë lirshëm mendimin e vet⁴⁶. Për këtë arsye, Bashkimi Demokratik i kërkoi popullit shqiptar të “kundërshtonte zgjedhjet duke abstenuar, dhe nëse abstenimi nuk do të ishte i mundur, asnjë votë nuk duhet të hidhej për kandidatët e Frontit⁴⁷”.

E mbetur pa njohje ligjore, pa mjete propagande dhe nën vëzhgimin e rreptë të organeve të policisë sekrete, për opozitën u bë e pamundur të fitonte sado pak hapësirë për t’u organizuar gjatë fushatës zgjedhore. Në këtë mënyrë, asnjë grup i opozitës nuk mundi të paraqiste kandidatë alternativë. Megjithatë, në listat e kandidatëve për zgjedhje arritën të përfshiheshin dhe dy kandidatë të pavarur.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ NARA, Record of the US Department of State, relating to the internal affair of Albania 1945-1949, roll 1, Department of State, Decimal file 875.00/12-1245

⁴⁷ Po aty.

Në 27 nëntor 1945, ndryshe nga çfarë parashikonte ligji për zgjedhjet⁴⁸, grupi Bashkimi Shqiptar i Shkodrës u arrestua. Arsyet se përse u zgjodh arrestimi i tyre vetëm një javë para zgjedhjeve mund të jenë disa. Sipas komunikimit të drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, Spiro Pano për ministrin e brendshëm, kështu do të shmangej një demonstratë antikomuniste që, do të organizohej nga grupi i mësipërm. Peticioni që i ishte dërguar Misioneve të huaja në Shqipëri, ishte një arsye tjetër shumë e fortë për arrestimin e këtij grupi. Gjithashtu, ky grup përfshinte shumë klerikë katolikë, të cilët e kishin treguar hapur se nuk e mbështesnin qeverinë provizore. Me arrestimin e këtij grupi, udhëheqësit komunistë kërkonin të frikësonin të gjithë opozitën për ta larguar atë nga ideja e abstenimit.

Pozita e PKSh ndryshonte në mënyrë drastike me atë të opozitës antikomuniste. Ajo, e kamufluar brenda Frontit Demokratik, drejtonte gjithçka në lidhje me zgjedhjet dhe fushatën zgjedhore. Drejtuesit më të lartë të PKSH i perceptonin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, si një koncesion që ata po bënin⁴⁹. Në konceptin e komunistëve, populli e kishte vendosur formën e regjimit në Shqipëri dhe ky ishte “regjimi popullor”. Kjo do të thotë që për komunistët zgjedhjet ishin diçka formale që do t’i shërbenin më shumë për të siguruar legjitimitetin në arenën ndërkombëtare. PKSH e kishte shumë të qartë se pozita e qeverisë së saj ishte ende e diskutueshme në planin ndërkombëtar.

Në 22 tetor 1945 zhvilloi punimet Plenumi i IV i KQ të PKSH. Një vend të rëndësishëm në diskutimet e tij e zuri fushata e zgjedhjeve dhe përgatitjet për to. Në parashitjet e tij, Enver Hoxha, me cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të PKSH, analizoi situatën e përgjithshme në vend. Sipas tij, PKSH kishte arritur të kontrollonte situatën e brendshme, por nuk kishte bërë ndonjë përparim në atë ndërkombëtare. “Zgjedhjet, – tha ai, – do të jenë një masë që do të influencojnë aleatët”⁵⁰. Për të arritur këtë, Enver Hoxha, porosiste që duhet të mos kishte dhunë gjatë fushatës së zgjedhjeve⁵¹. Duke pasur parasysh masat policore që ishin zbatuar deri në atë kohë, edhe Koçi Xoxe porosiste se “me daljen (shpalljen S.B.) e

⁴⁸ Në nenin 4, paragrafi 5 të ligjit për zgjedhjet thuhet qartë se “dhjetë ditë para zgjedhjeve dhe pesë ditë pas zgjedhjeve asnjë organ i pushtetit nuk mundet për asnjë arsye të thërrasë ndonjë zgjedhës”.

⁴⁹ AQS, Fondi 14/AP org. udh., viti 1945, dos. 1, fl. 11.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 9.

⁵¹ *Po aty*.

ligjit, organet tona të pushtetit të mbajnë një qëndrim të drejtë, pa masa policore⁵²”. Porosia e udhëheqësve të PKSH ishte se Fronti nuk duhej të arrinte një fitore të zakonshme, por të fitonte bindshëm. “Nuk është puna të fitojmë, - porosiste E. Hoxha, - por të fitojmë në mënyrë “schiacciante (shtypëse S.B.)”⁵³.

Sejfulla Malëshova nuk kishte të njëjtin mendim me Enver Hoxhën për sukseset e arritura në planin e brendshëm. Ai pohoi se populli shfaqte pakënaqësi në lidhje me gjendjen. Arsyet e pakënaqësisë, sipas tij ishin: “çfarë kemi premtuar në Luftë dhe çfarë japim; d.m.th. masat pretendojnë më shumë se ç’mund të marrin në realitet”⁵⁴.

Në 7 nëntor 1945 u shpallën listat e kandidatëve. Lista e Frontit kishte 108 kandidatë për 82 vende. 26 kandidatët e tjerë bënë pjesë po në listët e kandidatëve të ndarë brenda Frontit, por edhe ata në shumicën e rasteve ishin pro komunistë. Kështu, në Korçë kandidonte për të njëjtën zonë Miha Lako dhe Pandi Kristo, në zonën e Dropullit kandidonte Lefter Konomi dhe Spiro Xhai. Të gjithë këta ishin komunistë, madje ishte paracaktuar fituesi. Për herë të parë, në listat e kandidatëve për asamblistë, ishin përfshirë dhe tre gra: Ollga Plumbi, kandidate e Tiranës; Liri Gega, kandidate e Vlorës dhe Naxhije Dume, kandidate e Korçës. Paraqitën kandidaturën edhe dy kandidatë të pavarur jo komunistë në Korçë e Vlorë. Kandidati i Korçës u tërhoq vetëm një ditë para procesit të votimeve.

Në 14 nëntor 1945 u botua në gazetën “Bashkimi” programi i Frontit Demokratik. Ai ishte një provë tjetër që PKSh nuk ishte e sigurt për mbështetjen, që forma e regjimit të propozuar prej saj, kishte në popull. Parimet e programit karakterizoheshin nga ambiguiteti. Fronti do të punonte për të instaluar një “regjim demokratik popullor”, por në program nuk përmendej “diktatura e proletariatit” si pjesë përbërëse e këtij regjimi. Gjithashtu në program pranohej se Fronti njihte dhe pranonte liritë themelore njerëzore dhe politike, si: “lirinë e fjalës, organizimit, të shtypit dhe të konfesionit”, por këto të drejta ishin për “masat e gjëra të popullit punëtor”⁵⁵. Në pjesën ekonomike të programit

⁵² *Po aty*.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 11.

⁵⁵ “Bashkimi”, 14 nëntor 1945.

ishte e qartë se Fronti do të zbatonte një program ekonomik të tipit sovjetik, por pranohej dhe e drejta e pronës private⁵⁶.

Fushata elektorale ashtu siç pritej u dominua tërësisht nga PKS, e cila angazhoi gjatë fushatës elektorale të gjitha mjetet e mundshme të propagandës. Ekipe të përbërë nga komunistë, përfaqësues të organizatave të gruas, rinisë etj., u shpërndanë në të gjitha qarqet e vendit për të zhvilluar fushatën elektorale, pro Frontit. Në asnjë rast gjatë fushatës nuk u përmend emri i PKS, madje dhe drejtuesit e lartë të saj nuk bënë fushatë jashtë rrethit të tyre elektoral. Fushata u pretendua se bëhej për Frontin Demokratik dhe për qeverinë provizore. Në festimet që organizoi PKS, me rastin e 6 nëntorit, përvjetorit të fitores së revolucionit bolshevik në Rusi, propaganduesit u porositën që të mos flisnin për revolucionin bolshevik në popull, por të festohej si një festë e rëndësishme për BS, që ishte një nga aleatët e Luftës.

Dita e zgjedhjeve dhe rezultati i tyre

Pas gjithë trukeve ligjore dhe propagandistike, si dhe dhunës shtetërore, në 2 dhjetor 1945 u zhvillua procesi i votimit për Asambleen Kushtetuese. Dita e zgjedhjeve u raportua se kaloi përgjithësisht e qetë, pa probleme serioze. Në bazë të urdhrin të dhënë nga Komiteti Qendror në 30 nëntor 1945, në çdo qendër votimi kishte gjallëri, kënge e valle dhe atmosferë festive. Kjo bëhej për t'i mbushur mendjen gazetarëve dhe fotoreporterëve të huaj, për entuziazmin me të cilin po i priste populli zgjedhjet. Entuziazmi popullor do ta bënte dhe më të besueshme fitoren e Frontit. Komitetet qarkore të qarqeve kishin nxjerrë njerëz në sheshet pranë qendrave të votimit, duke krijuar entuziazmin e pritshëm nga udhëheqësit e PKS. Duhet thënë, megjithatë, që jo në të gjitha krahinat, entuziazmi ishte i imponuar. Në krahina të ndryshme të vendit, kryesisht në Jug, populli i joshur nga propaganda kishte dalë të festonte për atë që ai e mendonte si qeveri të tij.

Procesi i votimit përfundoi ashtu siç pritej me fitoren e Frontit Demokratik. Të nesërmen u shpall fitorja e bujshme. Sipas të dhënave paraprake kishin votuar 89.8% e të regjistruarve në listat e votuesve. Nga këta 93.5% të votuesve kishin hedhur goglat për Frontin⁵⁷. Në qytetet kryesore të vendit pjesëmarrja në votime ishte me e ulët se mesatarja e

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ "Bashkimi", 3 dhjetor 1945.

vendit. Kështu, në Tiranë, në zonën ku kandidonte Enver Hoxha, morën pjesë 87,1% e votuesve, ndërsa në zonën tjetër të Tiranës ku kandidonte Ollga Plumbi, pjesëmarrja shkonte në 83.1%⁵⁸. Në qarkun e Vlorës, pjesëmarrja në votime nuk ishte më e madhe se 78.6%. Në zonat tradicionale të mbështetësve të legalistëve, si Krujë, Fushë-Krujë, Mat etj., numri i pjesëmarrësve në votime ishte edhe më i vogël dhe numri i atyre që votuan kundër ishte më i lartë se mesatarja e vendit⁵⁹. Në qarkun e Shkodrës, abstenimet kapnin dhe masën 23% - 28% të votuesve të regjistruar. Shumë e lartë ishte kjo përqindje brenda në qytetin e Shkodrës, si dhe në disa krahina, si: Dukagjin, Malësi e Madhe (Bajzë, Hot, Kastrat), Mirditë (Orosh, Fan etj), Lezhë (Breg i Matës, Zadrimë), Pukë (Iballë)⁶⁰.

Procesi i votimit u konsiderua i lirë dhe demokratik nga udhëheqësit komunistë. Por ai u konsiderua, gjithashtu, i pranueshëm nga misionet britanike dhe amerikane në vend. Raporti i Misionit Ushtarak Britanik njofton se përfaqësuesit e tij kishin mundur të vëzhgonin qendra votimi në Shkodër, Krujë, Lezhë, Milot, Mamurras, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier dhe Vlorë. Konkluzionet e vëzhgimit ishin se: “pavarësisht çdo lloj presioni që mund të jetë ushtruar para votimeve, në ditën e votimit nuk pati frikësim të dukshëm”⁶¹. Të njëjtin përfundim jep dhe drejtuesi i Misionit Civil Amerikan, Xheikobs në raportin e tij⁶².

Duket se udhëheqësit komunistë kishin arritur atë që donin: t’u tregonin misioneve të huaja se kishin mbështetjen e pjesës dërmuese të popullsisë shqiptare. Por, në të vërtetë procesi i votimit pati një sërë mangësish dhe të metash. Ndër më të rëndësishmet mund të përmendim: *Së pari* nuk munguan rastet e manipulimeve. Në qarkun e Durrësit, në zonën e Kavajës, sipas një raporti të Adil Çarçanit, u fshehën goglat e kutisë pa kandidat⁶³. Po kështu, në qarkun e Peshkopisë, katundi Lojmë të Lumës, ishin marrë 53 gogla nga kutia pa kandidat dhe i kishin hedhur në kutinë e Frontit.

⁵⁸ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 58, fl. 6.

⁵⁹ Po aty, fl. 76.

⁶⁰ Po aty, fl. 123-129.

⁶¹ NARA, Record of the US Department of State, relating to the Internal Affair of Albania 1945-1949, Department of State Decimal file 875.00/12-1245.

⁶² Po aty.

⁶³ AQSH, Fondi 14/AP strukturë, viti 1945, dos. 58, fl. 36.

Së dyti, nuk u respektua parimi i fshehtësisë së procesit të votimit. Në të gjitha raportet e dërguara Komitetit Qendror të PKSH, pas procesit të votimit theksohej se ishin identifikuar individët që kishin votuar kundër. Se çfarë metodash janë përdorur për këtë qëllim, kjo është ende e paqartë. Megjithatë, një sugjerim na e jep një njoftim që vjen nga Berati, sipas të cilit “një shok kishte hequr cohën e kutisë së fshehtë me qëllim, që të ndihesh vota”⁶⁴. Kjo mund të ketë shërbyer si një mjet frikësimi për kundërshtarët, në mënyrë që t’i detyrojë ata të mos e hedhin goglën në kutinë pa kandidat.

Së treti, nuk munguan dhe rastet e hapura të detyrimit për të votuar për kandidatët e Frontit Demokratik. Raportimi i zv/komisarit të Divizionit të Dytë, Myzafer Trebeshina, njofton se në Shkodër “ditën e 2 dhjetorit, qysh herët në mëngjes ushtria kishte shkuar në qendrat e votimit”⁶⁵, duke sforcuar rritjen e entuziazmit të popullit. Gjithashtu në një njoftim që vjen nga krahina e Petrelës, këshilli mbikëqyrës (komisioni) duke parë se goglat ishin hedhur në kutinë pa kandidat, pezulloi votimin dhe dolën jashtë për t’i bindur njerëzit të votonin në kutinë e kandidatëve të Frontit Demokratik⁶⁶.

Raportet në një masë të madhe nuk japin shifra se sa këto parregullsi mund të kenë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme në vend menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, pozitën e favorshme të Frontit si udhëheqës i rezistencës shqiptare, politikën e ndjekur nga drejtuesit e qeverisë provizore: propagandën, dhunën, përjashtimet nga listat elektorale etj. fitorja e Frontit në zgjedhjet e 2 dhjetorit ishte diçka e pritshme. Por sigurisht, nëse procesi do të ishte i rregullt Fronti Demokratik do të kishte deklaruar një fitore më pak të bujshme.

Pas kësaj fitoreje, në 10 janar 1945 u mblodh Asambleja Kushtetuese, e cila një ditë më vonë e shpalli shtetin shqiptar, Republikë Popullore.

Konkluzione

Nga analiza e gjendjes politike gjatë vitit 1945, e paketës ligjore për zgjedhjet dhe e zhvillimit të tyre mund të arrijmë në disa konkluzione:

⁶⁴ *Po aty*, fl. 99.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 122-124.

⁶⁶ *Po aty*.

Së pari, zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 i shërbyen PKSh për të legjitimuar pushtetin e saj, që shprehej nëpërmjet Frontit Demokratik. Populli votoi për kandidatët e Frontit Demokratik dhe jo për PKSH. Fronti ishte forca politike që kishte dalë me fitore nga lufta; gjithashtu në programin e tij pranohehin liritë themelore, civile dhe politike, gjë që i joshi qytetarët shqiptarë. Prandaj në shumicë ata e hodhën votën për Frontin. Të paktë ishin ata që kuptonin se vota për Frontin Demokratik, ishte vota për regjimin diktatorial që mendonte të vendoste PKSH.

Së dyti, fitorja e Frontit, ndonëse ishte e pritshme dhe e kuptueshme, nuk ishte aq spektakolare sa u paraqit. Në Veri vetëm 80% kishin votuar për kandidatët e Frontit. Edhe në qytetet e mëdha përqindja e votimit për to ishte më e ulët se ajo në të gjithë vendin, rreth 80%. Të tilla rezultate pati Prefektura e Durrësit, Tiranës, Shkodrës dhe Peshkopisë. Nuk kishte kandidatë të opozitës, por votat kundër kandidatëve të Frontit ishin në fakt vota “për opozitën”. Numri i tyre arriti deri më 36.758 ose 6.76%, në shkallë vendi. Në qytetet kryesore, si: Tiranë, Durrës votuesit kundër Frontit arritën deri në 12-13%. Nëse do të llogarisim si vota kundër Frontit edhe ata individë që nuk mundën të votonin, pasi në mënyrë arbitrare iu hoq kjo e drejtë; individët që zgjedhën abstenimin për të treguar kundërshtimin e tyre ndaj Frontit, dhe votat e atyre që votuan kundër, atëherë fitorja e Frontit është më e vogël.

Së treti, mandati popullor i “pushtetit popullor” mbetet i diskutueshëm. Gjatë viteve 1946-1948, 20 deputetë nuk mundën të mbarojnë mandatin. Nga këta 14 asamblastë, kundërshtarë të regjimit komunist u çmandatuan, u burgosën dhe u dënuan si kundërshtarë të “pushtetit popullor” gjatë viteve 1946-1947. Dy asamblastë, krerë të besimit bektashi, janë vrarë në rrethana të dyshimta. Të tjerët u eliminuan si pasojë e luftës së brendshme të PKSh.

Si përfundim mund të themi se zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 ishin një moment crucial në historinë e PKSh për vendosjen e monopolit të saj mbi pushtetin në vend. Nga 82 deputetë, 55 ishin anëtarë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe 27 anëtarë të rinj të Frontit Demokratik. Nuk pati asnjë deputet independent ose të opozitës. Pas zgjedhjeve, PKSh përdori çdo mjet e çdo rrugë për ta ruajtur këtë monopol.

S u m m a r y

THE ELECTION OF 2 DECEMBER 1945

(The event that brought into power or legitimated the power of the communists)

The elections of 2 December 1945 were an important moment in the history of KPA and in establishing the monopoly on power in the country. They ended a process that had started since the WWII.

The Albanian communists after had been able to take the power needed now to legitimate it. The decisions taken in the Conference of Yalta conditioned the recognition of the new provisory governments in the liberated countries with the conduct free and democratic elections. Such a condition was also put forward also to Albanian government by the western allies: USA, and Great Britain.

The Albanian communist government in order to guarantee its own power made all the efforts to ensure the victory in the elections of 2 December 19345 by maintaining the image of free and democratic elections. During a period of almost one year it:

Firstly, conducted a violent campaign in all the regions where the population had not supported the communists by putting them under control through use of fear.

Secondly, it made careful use of the propaganda in favour of the Democratic Front by exploiting for this reason individuals with influence in different area of the country which were not in support of the communist regime.

Thirdly, it compiled a legislative body that was contradictory and made it impossible in reality the participation of other political forces in the elections.

Fourthly, it made all the efforts to halt the creation of political parties of opposing nature.

In this manner the KPA it ensured the victory in the elections of 2 December 1945. The victory of the Democratic Front was not as spectacular as presented. In the prefecture of Durrësi, Tirana, Shkodra and Peshkopia only 80% of the voters had voted for the candidates of the Front while abstained voters were plentiful. They reached up to 36.758 votes or 6.76% of the registered population. If it will be counted as votes against the Front all of the individuals that could not vote (because in an arbitrary way they had no right to vote), the persons that chose to abstain in order to show their disagreement with the Front and the votes against it then the victory of the Front and of the "popular" regime that was established in the country was more disputable.

